



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

Nr. 842/8 Prot.

Durrës, më 09.09. 2020

VENDIM

Nr. 5, datë 27.02. 2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR, PUS-SHPIMI, PUSI
NR.2 , NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË KRUIË, BASHKIA KRUIË, PËR
SUBJEKTIN "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SH.A PËR QËLLIME "UJË I
PIJSHËM"

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 12, pika 1, gërma "e" të nenit 41, pikës 2 të nenit 50, pikës 2 të nenit 56, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre" dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për përdorimin e një pus shpimi, pusi nr.2", subjektit "Tirana International Airport" sh.a për qëllime "Ujë i pijshëm".
1. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Roland Nasto

